



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:282802
Datë: 17.07.2024
Numri i dokumentit: 05946783

K.DH.SH.II.nr.964/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Krenar Berisha, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Lego” Shpk me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.RR., kundër të paditurve Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Ardian Dauti dhe 2. Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës me seli në Prishtinë të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Zana Morina, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.128/22 të datës 14.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.07.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit “Lego” Shpk me seli në Prishtinë, e datës 05.04.2024 ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.128/22 i datës 14.03.2024, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin e ankimuar KA.nr.128/22 të datës 14.03.2024, nën pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit, ka

vendosur, Refuzohet në tërsi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit “Lego” Shpk me të cilin ka kërkuar anulimin e vendimit PSH.nr.370-401/2019 të datës 26.08.2019 të nxjerrë nga i padituri i parë Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe kompensimin e dëmit material nga i padituri i dytë Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës-SHSKUK. Nën pikën II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë paditësi, përmes përfaqësuesit së autorizuar, për shkak të: shkeljes thelbësore të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të Dhoma e Shkallës së Dytë të merr aktgjykim me të cilin aprovohet plotësisht si e bazuar ankesa e paditësit “Lego” Shpk-Prishtinë, të anulohet aktgjykim i Gjykatës Komerciale-Departamenti për Çështje Administrative, Dhoma e Shkallës së Parë, KA.nr.128/22 i datës 14.03.2024 dhe lënda kthehet në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kundërshtuar të Panelit Shqyrtues të Prokurimit Publik, PSH.nr.370-401/2019 të datës 26.08.2019, nën pikën I të dispozitivit të vendimit, janë aprovuar si pjesërisht e bazuar ankesat e operatorëve ekonomik “Lego” Shpk-Prishtinë, me nr.370/19 dhe Operatorit ekonomik “Liri-Med” Shpk-Prishtinë me numër 401/19, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me barna nga lista esenciale për nevojat e SHSKUK-së” me nr. të prokurimit: 19-2198-1-1-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës/SHSKUK. Nën pikën II, Vërtetohet njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me barna nga lista esenciale për nevojat e SHSKUK-së” me nr. të prokurimit: 19-2198-1-1-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës/SHSKUK. Nën pikën III, Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues

për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Nën pikën IV. Mosrespektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore te nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092 të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues. Nën pikën V. Meqenëse ankesa e operatorëve ekonomik ankues: “Lego” Shpk-Prishtinë dhe OE ankues “Liri-Med” Shpk-Prishtinë, aprovohen pjesërisht si të bazuara i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Ndërsa nën pikën VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Paneli Shqyrtues i Prokurimit Publik, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 24.09.2019, me pretendim se vendimi i të paditurës është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Dhoma e Shkallës së Parë pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit të paditurës dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar. Me arsyetim se Nga provat e administruara në këtë çështje, gjykata vlerëson se i padituri i parë, Organi Shqyrtues i Prokurimit në përputhje me dispozitat ligjore ka nxjerr Vendimin PSH.nr. 370-401/2019 i datës 26.08.2019, përmes të cilit ishte aprovuar pjesërisht si e bazuar ankesa e paditësit dhe ishte vërtetuar Njoftimi për kontratë me titull “Furnizim me Barna nga lista Esenciale për nevojat e SHSKUK-së” me numër të prokurimit 19-2198-1-1-1 për Lot 18, iniciuar nga autoriteti kontaktues (AK), Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës. Gjykata po ashtu vlerëson se i padituri i dytë Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës në përputhje me dispozitat ligjore ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me Barna nga lista Esenciale për nevojat e SHSKUK-së” me numër të prokurimit 19-2198-1-1-1 pasi që çmimi I ofertuar nga “Pharma Leader” ishte çmimi më i ulët në vlerë prej 74,736.00€ ndërsa çmimi i ofertuar nga paditësi ishte 130,788.00€. Për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur, gjykata iu referua nenit 60 par. 1, pika 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik i cili përcakton se “1. Autoriteti kontraktues do t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët”. Gjatë ka vlerësuar pretendimet e paditësit se OE i

rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kriteret lidhur me dozën e barit Paracetamol siç janë kërkuar në dosjen e tenderit, por gjykata këto pretendime të paditësit i vlerësoi si të pabazuara pasi që nga provat e administruara, gjykata vlerëson se Autoriteti Kontraktues duke iu referuar nenit 59, par. 4 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik. Prandaj gjykata vlerëson se me të drejtë i padituri i dytë ka rekomanduar për kontratë OE “Pharma Leader” sepse ndryshimi i dozës për barin Paracetamol nga “500mg” në “1000mg” nuk përbën ndryshim substancial nga dosja e tenderit sepse për të dy dozat e produktit qëllimi i përdorimit është i njëjtë, ndërsa rritja e sasisë së ofertuar nuk mund të trajtohet si ofertë me variante pasi që produktit është i ofertuar nga OE i rekomanduar për kontratë është i njëjtë ndërsa ndryshon vetëm sasia. Po ashtu lidhur me këtë, gjykata vlerësoi se nga oferta e OE të rekomanduar është vërtetuar se i njëjti ka ofertuar sasinë e kërkuar me dosje të tenderit por me dozë dyfish, pra përkundër që ka ofertuar me dozë dyfish më të madhe nuk ka zvogëluar sasinë e kërkuar në dosjen e tenderit, përkatësisht ka ofertuar sasinë prej 34600 copë, aq sa ka qenë kërkesa në dosjen e tenderit. Prandaj, gjykata vlerëson se të padituri në procedurë administrative me të drejtë këtë e kanë trajtuar si devijim të vogël që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, vlerësim ky në përputhje edhe me nenin 6 të LPP-së i cili përcakton se: “1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit”. Gjykata përfundimisht vlerëson se i padituri i parë me rastin e refuzimit të ankesës së paditësit në procedurë administrative, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe dispozitat tjera materiale të cituara më lartë, andaj edhe refuzoi kërkesën e padinë për kompensimin e dëmit.

Qëndrimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Dhoma e Shkallës së Parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se ekziston vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë për faktin se nuk janë shqyrtuar drejtë dhe në tërësi dëshmitë, provat dhe pretendimet me arsyetime konkrete të paditësit për anulimin e vendimit të OSHP-së. Paditësi ka sqaruar se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofertuar sipas kërkesës së dosjes së tenderit, prandaj është dashur të eliminohet si OE i papërgjegjshëm. Ky OE ka ofertuar me dozë të produktit prej 1000mg, ndërsa kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë që të ofertohej me 500mg. Doza e përcaktuar në dosjen e tenderit prej 500mg për barin Paracetamol është përgatitur nga Autoriteti Kontraktues-SHSKUK në pajtim të plotë me listën esenciale të Ministrisë së Shëndetësisë dhe ky produkt me specifikat e saj teknike është përshkruar në faqen 45 të listës esenciale. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, ngase Dhoma e Shkallës së Parë me të drejtë i është referua nenit gjykata vlerëson se Autoriteti Kontraktues duke iu referuar nenit 59, par. 4 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik i cili përcakton se: *“4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.”* Kolegji vlerëson se në këtë rast Autoriteti Kontraktues me të drejtë ka rekomanduar për kontratë OE “Pharma Leader” sepse ndryshimi i dozës për barin Paracetamol nga “500mg” në “1000mg” nuk përbën ndryshim substancial nga dosja e tenderit sepse për të dy dozat e produktit qëllimi i përdorimit është i njëjtë, ndërsa rritja e sasisë së ofertuar nuk mund të trajtohet si ofertë me variante pasi që produktit është i ofertuar nga OE i rekomanduar për kontratë është i njëjtë ndërsa ndryshon vetëm sasia. Andaj, për këtë arsye Dhoma e shkallës së dytë i vlerësoi si të pa bazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat nuk kanë gjetur mbështetje në dispozitat ligjore materiale të cilat rregullojnë këtë çështje dhe nuk kanë qenë në përputhje me provat e administruara për të vendosur ndryshe në këtë çështje administrative.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të

paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore se vendimi i Dhomës së Shkallës së Parë nuk përmban arsytetime konkrete dhe nuk ka bërë vlerësim të drejtë dhe të plotë të fakteve e po ashtu ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale, kur ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit. Ky kolegji këto pretendime ankimore nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pa bazuara, përkatësisht të pa argumentuara me prova konkrete, ngase sipas vlerësimit kolegjit aktgjykimi i ankimuar i Dhoma e Shkallës së Parë është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij i janë dhënë arsyet të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë. Andaj, kolegji i vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë, dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë të paditësit dhe lënies në fuqi të vendimit të paditurës, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të njëpasnjëshme një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.964/24, me datë 11.07.2024

Kryetare e kolegjit,
Franciska Zhitija Ymeri